



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

**Rregullore**

**“Për administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër”**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Plotësimi i kuadrit rregullator për funksionin e kullimit.

**Neni 2**

**Objekti**

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen të drejtat dhe detyrat e Njesisë së Kullimit (të Bashkisë), përfituesve, ndërmarrjeve, enteve publike, institucioneve, organeve të administratës, OJQ dhe të subjekteve të tjera, sa i takon kushteve minimale dhe metodologjise për mbajtjen në funksionim të rrjetit të kullimit si dhe mënyrat e ndërveprimit reciprok ndërmjet tyre.

**Neni 3**

**Përkufizime**

Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” dhe me aktet nënligjore në zbatim.

**Neni 4**

Shërbim i kullimit në vështrim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a. pastrimi dhe mbajtja në funksion i kanaleve kulluese pronë e bashkisë Shkodër;
- b. riparimi dhe mbajtja në funksion i veprave të artit të ketyre kanaleve;
- c. mirëmbajtje të infrastrukturës ndihmëse prone e bashkisë/ose jo që lejon ndërhyrje në rrjetin e kanaleve.
- d. rehabilitimi dhe rikonstrukcioni i çdo infrastrukture tjetër të kullimit.
- e. aktivitete që kanë të bëjnë më funksionin e kullimit dhe nuk rregullohen me akte të tjera të veçanta.

## **Neni 5**

Objekte të sistemit kullues, në vështrim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a. rrjeti i tërësishëm i kanalizimeve kulluese me kanale të ndërtuara/tubacione dhe kanale natyrore;
- b. veprat përkatëse hidroteknike, veprat e artit (porta, tumbino, etc.);
- c. rrugët publike të ngastrave/arave që janë në funksion të kullimit;
- d. rrugët e shërbimit;
- e. toka bashkëngjitur me kanalet kulluese;
- f. ndërtesat administrative, stacionet e pompave të kullimit në shërbim të funksionit;
- g. skemat e kullimit, projektet teknike dhe çdo inventar në shërbim të funksionit të kullimit;
- h. çdo objekt tjetër që krijohet gjatë ushtrimit të funksionit për llogari të funksionit.

## **Neni 6**

Për ekzekutimin e funksionit të kullimit, Bashkia, krijon njësi ekonomike varësie, struktura administrative, kontrakton, apo delegon kryerjen e shërbimit sipas ligjeve në fuqi.

## **II. DISPOZITAT E VEÇANTA**

### **Neni 7**

#### **Njësia Përgjegjëse për Kullimin.**

Për ushtrimin e funksionit të kullimit Bashkia në përputhje me legjislacion në fuqi krijon Njesisë Përgjegjëse për Kullimin si Person Juridik të veçantë.

### **Neni 8**

#### **Të drejtat dhe përgjegjësitë e Njesisë Përgjegjëse për Kullimin(N.P.K).**

- a. Funksionon si Person Juridik më të gjitha tagret që i jep pronari.
- b. Ka selinë dhe vulën e vet.
- c. Organizon veprimtarinë e vet mbështetur në inventarin (asetet) dhe fondet që i vihen në dispozicion nga Bashkia, transfertat specifike nga Qeveria, donacionet dhe të ardhurat që i krijon sipas ligjit.
- d. Mban inventarin e pasurive (aseteve) që i janë vënë në dispozicion për përmbushjen e funksionit të kullimit.
- e. I propozon pronarit listën e asetëve që kanë humbur funksionin e tyre në drejtim të funksionit të kullimit dhe që mund të përdoren për qëllime të tjera ekonomike.
- f. Mban planimetritë që tregojnë zonat e shërbimit të kullimit.

- g. Mban regjistrin e ngastrave sipas skemave të kullimit, i cili përshkruan madhësinë dhe vendndodhjen e pronës së çdo pronari/përdoruesi dhe rishikon atë çdo vit në bashkëpunim me zyra/institucione të tjera.
- h. Mban regjistër për pagesat e detyruara, tarifën për t'u paguar dhe ato të paguara.
- i. Mban regjistër për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së kullimit, si dhe regjistër për inspektimet dhe kontrollet e digave, sipas legjislacionit përkatës.
- j. Bën regjistrimin e sipërfaqes mbi të cilën është vendosur sistemi kullues, së bashku me strukturat përkatëse, në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, ku bëhet edhe regjistrimi i servituteve të krijuara në bazë të legjislacionit.
- k. Mban llogari të faturave dhe të shpenzimeve, si dhe përgatit bilancin vjetor e raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.
- l. Vënë në dispozicion të Ministrisë/Bashkisë të dhëna dhe dokumentacion për shfrytëzimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës që u është transferuar atyre, në përputhje me dispozitat e ligjit 24/2017 “Për ujtitjen dhe kullimin” dhe dispoziten e akteve të tjera ligjore në fuqi.
- m. Bën planin e shfrytëzimit dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve si dhe çdo infrastrukturë në funksion të kullimit të parashikuara sipas kësaj rregulloreje.
- n. Kontrollon dhe siguron funksionimin normal të sistemit të kullimit.
- o. Bën planin për investime në infrastrukturën e funksionit.
- p. Harton kushtet teknike të zbatueshme për lidhjet në rrjet, ndërtimin e veprave të artit dhe kontrollon zbatimin e tyre.
- q. Realizon informimin e detyrueshëm të shfrytëzuesit/përdoruesit mbi shkaqet dhe periudhën kohore të ndërprerjes së funksionimit.
- r. Realizon njoftimin e përdoruesve së paku 24 orë më parë në rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara më parë të funksionit. Njoftimi bëhet për datën dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes.
- s. Merr masa për paisjen më leje të nevojshme të çdo ndërhyrje që behet në sistemin e kullimit si dhe ruan zbatimin e kushtëzimeve që i vendos paraprakisht në përputhje më bazën ligjore që rregullon veprimtarinë.
- t. Bën studime në lidhje me gjendjen e funksionimit të sistemit të kullimit si dhe për ndikimin e funksionimit të këtij sistemi në tokën bujqësore dhe proceset agropedologjike të saj.
- u. Pas çdo ndërhyrje në sistemin e kullimit, kujdeset që të vendosë në gjendjen optimale të funksionimit të gjithë infrastrukturat që i janë nënshtruar ndërhyrjeve nga njësi ose njësi të tjera.
- v. Përgatit terma reference për prokurimin e mallrave e shërbimeve që kanë të bëjnë më funksionin e kullimit.
- w. Mban lidhje të vazhdueshme me çdo institucion dhe bashkëpunon për realizimin e funksionit të kullimit.

## **Neni 9**

### **Përdoruesit e sistemit të kullimit**

Përdoruesit e sistemit kullues, janë të detyruar që ta mirëmbajnë dhe ta shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar sipas kësaj rregulloreje, duke pasur parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve duhet të jenë në funksion të shërbimit që ato kryejnë dhe të rëndësisë që kanë.

Përdoruesit e sistemit të kullimit, kujdesen për mbrojtjen e këtij sistemi ashtu siç parashihet në këtë rregullore.

## **Neni 10**

Detyrimi për të siguruar akses.

Pronari apo përdoruesi i tokës bujqësore ngjitur me sistemin e kullimit që i shërben ngastres është i detyruar të lejojë përdorimin e pronës për kontrollin, kalimin dhe kryerjen e punimeve në sistemin e kullimit.

## **III. INFORMIMI DHE VEPRIMI I STRUKTURAVE VENDORE**

## **Neni 11**

- a. Kryepërqendër në bashkëpunim me Njësitë Administrative në kompetencat e parashikuara të ligjit Nr. 139/2015 kryen kontrollin mbi territorin dhe njofton strukturën përgjegjëse siç është Njësia e Kullimit.
- b. Njësia e Kullimit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake marrin masa dhe veprime administrative të parashikuara në këtë rregullore.
- c. Njësia e Kullimit është e detyruar të japë çdo informacion teknik në lidhje me kanalet kulluese Njësive Administrative.

## **IV. NDALIMET DHE PENALITETET**

## **Neni 12**

Gjatë shfrytëzimit/përdorimit të rrjetit të kanalizimit, ndalohet:

- a. hedhja e mbeturinave urbane të çdo lloji, mbetje të ngurta apo e lëngta në hapësirat e sistemit të kullimit.
- b. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve nga bordura e kanalit kullues (vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues), brenda një largësie 4 metër.

- c. hedhja apo shkarkimet nga mbetjet industriale, apo përpunuese, të stallave, baxhove, apo nga aktivitete të tjera me impakt në mjedis, etj
- d. çdo lloj ndërhyrje në sistemin kullues, ndërhyrje në veprat e artit, vendosja e veprave të reja të artit, gjurmimi, devijimi i vijave të ujit, mbulimi i atyre ekzistuese natyrore apo të ndërtuara nga njeriu dhe çfarëdo modifikimi në objektet e kanalizimit pa leje nga Njësia Përgjegjëse për Kullimin dhe Bashkia.

### **Neni 13**

Kryerja e shkeljeve dhe kundravajtjeve denohen si më poshtë:

- a. hedhja e mbeturinave urbane të çdo lloj, mbetjeve të ngurta.
- b. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve nga bordura e kanalit kullues ( vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues) , brenda një largësie 4 metër.
- c. hedhja apo shkarkimet nga mbetjet industriale, apo përpunuese, të stallave, baxhove, apo nga aktivitete te tjera me impakt në mjedis, etj..
- d. çdo lloj ndërhyrje në sistemin kullues, ndërhyrje në veprat e artit, vendosja e veprave të reja të artit, gjurmimi, devijimi i vijave të ujit, mbulimi i atyre ekzistuese natyrore apo të ndërtuara nga njeriu dhe çfarëdo modifikimi në objektet e kanalizimit pa leje nga Njësia Përgjegjëse për Kullimin dhe Bashkia.
- e. Pengimi, bllokimi në mënyra të tjera i stafit të autorizuar për inspektimin e infrastrukturës, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr 24/2017 dhe nenin 10 të kësaj rregulloreje.
- f. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionura në këtë rregullore nga ana e Njesisë Përgjegjëse të Kullimit.
- g. Njësia përgjegjëse e kullimit në rast se konstaton kundër-vajtjet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "d" të këtij neni njofton Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Kundër-vajtjet dënohen me 50 mijë lekë gjobë dhe kundër-vajtësi është i detyruar të përballojë shpenzimet për rikthimin e objektit në gjëndjen e mëparëshme (neni 46 pika 2 e ligjit nr 24/2017, "Për administrimin e ujtitjes dhe të kullimit").
- h. Kundër-vajtjet e parashikuar në shkronjat "e" dhe "f" dënohen me 25 mijë lekë gjobë nga Bashkia konform dispozitave ligjore.

## **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Neni 14**

Strukturat ekzistuese që administrojnë funksionin e kullimit vazhdojnë veprimtarinë e tyre deri në momentin që përshtaten në përputhje me rregulloren nga Organi Kompetent.

## Neni 15


Rregullorja mund të përmirësohet në përshtatje me aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit 24/2017 “Për ujitjen dhe kullimin” duke synuar integrimin e saj më kuadrin rregullator që do të hartohet për ujitjen dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

## MBIKËQYRJA

## Neni 16


Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, e kryejnë organet kompetente të Bashkisë.

**Sekretar i këshillit**



**Suel Hadri**

**KRYETAR**



**Xhemal BUSHATI**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**

---

Nr. 5265/Prot  
16

Shkodër, më 15.12.2017

Lënda: Dërgohet Projekt-vendimi , Rregullorja për “Administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër”.

**KËSHILLIT TË BASHKISË**  
**Shkodër**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Bashkëlidhur ju dërgojmë Projekt-vendimin, Rregulloren dhe Relacionin shpjegues, për shqyrtim dhe miratim nga ana juaj.

Duke ju uruar punë të mbarë,

Me respekt,

**KRYETAR**  
  
**Voltana Ademi**  




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA SHKODËR**  
**Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve**

Nr. 5265/15 Prot

Shkodër, më 15.12.2017

**RELACION**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**"PËR ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT NË BASHKINË**  
**SHKODËR"**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.11.2017, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 27, 33 pika 2 të ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ligjit nr.24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe kullimit", Kreu IV, neni 15 "Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive", në funksion të ujitjes dhe kullimit ka miratuar "Planin e Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit", i miratuar me V.K.B. nr 76, datë 30.11.2017.

Në zbatim të përmbushjes së këtij plan veprimi, Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve, ka hartuar një rregullore "Për administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër".

Gjatë procesit të konsultimit të Planit të Veprimit për Përmirësimin e Shërbimit të Kullimit është bërë dhe konsultimi për këtë rregullore

Për këtë janë kryer:

- 10 Workshope e seminare.
- 6 Takime në njësi administrative me stafin e qytetarët për të prezantuar rregulloren e hartuar.
- 5 Takime me fokus grupet e qytetarët.



Në këto takime kanë marrë pjesë mbi 200 persona të ndryshëm të cilët kanë dhënë mendimet e tyre në hartimin e dokumentit.

Rregullorja e paraqitur për t'u miratuar nga ana e juaj përmban këto elemente kryesore :

I. Dispozitë e përgjithshme.

- Qëllimi
- Objekti
- Përkufizime

II. Dispozita të veçanta

- Njësia Përgjegjëse për kullimin
- Të drejtat dhe përgjegjësitë e Njesisë Përgjegjëse të Kullimit.
- Përdoruesit e sistemit të kullimit

III. Ndalimet dhe penalitetet

IV. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

V. Mbikëqyrja

Kjo rregullore do të shërbejë si një instrument shumë i rëndësishëm për menaxhimin me cilësi , efikasitet dhe efikasitet të të gjithë sistemit të kullimit të Bashkisë Shkodër.

Bashkangjitur Rregullorja "Për administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër ".

Me respekt,


Drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Trajtimit të AMTP-ve

Alban Sekja




KRYETAR

Voltana Ademi



Konceptuar A. Sekja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR

**Rregullore**

**“Për administrimin e shërbimit të kullimit në Bashkinë Shkodër”**

**I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Qëllimi.**

Plotësimi i kuadrit rregullator për funksionin e kullimit.

**Neni 2**

**Objekti.**

Në bazë të kësaj rregulloreje përcaktohen të drejtat dhe detyrat e Njesisë së Kullimit (të Bashkisë), përfituesve, ndërmarrjeve, enteve publike, institucioneve, organeve të administratës, ojq dhe të subjekteve të tjera, sa i takon kushteve minimale dhe metodologjise për mbajtjen në funksionim të rrjetit të kullimit si dhe mënyrat e ndërveprimit reciprok ndërmjet tyre.

**Neni 3**

**Përkufizime**

Termet e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me ato të përcaktuara në nenin 2 të ligjit nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit” dhe me aktet nënligjore në zbatim.

**Neni 4**

Shërbim i kullimit në vështrim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a. pastrimi dhe mbajtja ne funksion i kanaleve kulluese prone e bashkisë Shkoder;
- b. riparimi dhe mbajtja ne funksion i veprave te artit të ketyre kanaleve;
- c. mirëmbjatje të infrastrukturës ndihmëse prone e bashkisë/ose jo që lejon ndërhyrje në rrjetin e kanaleve.
- d. rehabilitimi dhe rikonstruksioni i çdo infrastrukture tjetër të kullimit.
- e. aktivitete që kanë të bëjnë më funksionin e kullimit dhe nuk rregullohen me akte të tjera të veçanta.

### ***Neni 5***

Objekte të sistemit kullues, në vështrim të kësaj rregulloreje, konsiderohen:

- a. rrjeti i tërësishëm i kanalizimeve kulluese me kanale të ndërtuara/tubacione dhe kanale natyrore;
- b. veprat përkatëse hidroteknike, veprat e artit (porta, tumbino, etc.);
- c. rrugët publike të ngastrave/arave që janë në funksion të kullimit;
- d. rrugët e shërbimit;
- e. toka bashkëngjitur me kanalet kulluese.
- f. Ndërtesat administrative, stacionet e pompave të kullimit në shërbim të funksionit.
- g. Skemat e kullimit, projektet teknike dhe çdo inventar në shërbim të funksionit të kullimit.
- h. Çdo objekt tjetër që krijohet gjatë ushtrimit të funksionit për llogari të funksionit.

### ***Neni 6***

Për ekzekutimin e funksionit te kullimit, Bashkia, krijon njësi ekonomike varësie, struktura administrative, kontraton, apo delegon kryerjen e shërbimit sipas ligjeve në fuqi.

## **II. DISPOZITAT E VEÇANTA**

### ***Neni 7***

#### **Njësia Përgjegjëse për Kullimin.**

Për ushtrimin e funksionit të kullimit Bashkia në përputhje me legjislacion në fuqi krijon Njesisë Përgjegjëse për Kullimin si Person Juridik të veçantë.



## **Neni 8**

### **Të drejtat dhe përgjegjësitë e Njësisë Përgjegjëse për Kullimin(N.P.K).**

- a. Funksionon si Person Juridik më të gjitha tagret që i jep pronari.
- b. Ka selinë dhe Vulën e vet.
- c. Organizon veprimtarinë e vet mbështetur në inventarin (asetet) dhe fondet që i vihen në dispozicion nga Bashkia, transfertat specifike nga Qeveria, donacionet dhe të ardhurat që i krijon sipas ligjit.
- d. Mban inventarin e pasurive (aseteve) që i janë vënë në dispozicion për përmbushjen e funksionit të kullimit.
- e. I propozon pronarit listën e asetëve që kanë humbur funksionin e tyre në drejtim të funksionit të kullimit dhe që mund të përdoren për qëllime të tjera ekonomike.
- f. Mban planimetritë që tregojnë zonat e shërbimit të kullimit.
- g. Mban regjistrin e ngastrave sipas skemave të kullimit, i cili përshkruan madhësinë dhe vendndodhjen e pronës së çdo pronari/përdoruesi dhe rishikon atë çdo vit në bashkëpunim me zyra/institucione të tjera;
- h. Mban regjistër për pagesat e detyruara, tarifrat për t'u paguar dhe ato të paguara;
- i. Mban regjistër për inspektimet dhe kontrollet e infrastrukturës së kullimit, si dhe regjistër për inspektimet dhe kontrollet e digave, sipas legjislacionit përkatës.
- j. Bën regjistrimin e sipërfaqes mbi të cilën është vendosur sistemi kullues, së bashku me strukturat përkatëse, në zyrën e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme, ku bëhet edhe regjistrimi i servituteve të krijuara në bazë të legjislacionit.
- k. Mban llogari të faturave dhe të shpenzimeve, si dhe përgatit bilancin vjetor e raportin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare
- l. Vënë në dispozicion të Ministrisë/Bashkisë të dhëna dhe dokumentacion për shfrytëzimin e mirëmbajtjen e infrastrukturës që u është transferuar atyre, në përputhje me dispozitat e ligjit 24/2017 “Për ujitjen dhe kullimin” dhe dispoziten e akteve të tjera ligjore në fuqi.
- m. Bën planin e shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve si dhe çdo infrastrukturë në funksion të kullimit të parashikuara sipas kësaj rregulloreje.
- n. Kontrollon dhe siguron funksionimin normal të sistemit të kullimit.
- o. Bën planin për investime në infrastrukturen e funksionit.
- p. Harton kushtet teknike të zbatueshme për lidhjet në rrjet, ndërtimin e veprave të artit dhe kontrollon zbatimin e tyre.



- q. Realizon informimin e detyrueshëm të shfrytëzuesit/përdoruesit mbi shkaqet dhe periudhën kohore të ndërprerjes së funksionimit.
- r. realizon njoftimin e përdoruesve së paku 24 orë më parë në rastin e ndërprerjeve lokale të planifikuara më parë të funksionit. Njoftimi bëhet për datën dhe kohëzgjatjen e ndërprerjes.
- s. Merr masa për paisjen më leje të nevojshme të çdo ndërhyrje që behet në sistemin e kullimit si dhe ruan zbatimin e kushtëzimeve që i vendos paraprakisht në përputhje më bazën ligjore që rregullon veprimtarinë.
- t. Bën studime në lidhje me gjendjen e funksionimit të sistemit të kullimit si dhe për ndikimin e funksionimit të këtij sistemi në tokën bujqësore dhe proceset agropedologjike të saj.
- u. Pas çdo ndërhyrje në sistemin e kullimit, kujdeset që të vendosë në gjendjen optimale të funksionimit të gjithë infrastrukturat që i janë nënshtruar ndërhyrjeve nga njësia ose njësi të tjera.
- v. Përgatit terma reference për prokurimin e mallrave e shërbimeve që kanë të bëjnë më funksionin e kullimit.
- w. Mban lidhje të vazhdueshme me çdo institucion dhe bashkëpunon për realizimin e funksionit të kullimit.

## ***Neni 9***

### ***Përdoruesit e sistemit të kullimit***

Përdoruesit e sistemit kullues, janë të detyruar që ta mirëmbajnë dhe ta shfrytëzojnë në mënyrën e caktuar sipas kësaj rregulloreje, duke pasur parasysh se pamja dhe gjendja e këtyre objekteve duhet të jenë në funksion të shërbimit që ato kryejnë dhe të rëndësisë që kanë.

Përdoruesit e sistemit të kullimit, kujdesen për mbrojtjen e këtij sistemi ashtu siç parashihet në këtë rregullore.

## ***Neni 10***

Detyrimi për të siguruar akses.

Pronari apo përdoruesi i tokës bujqësore ngjitur me sistemin e kullimit që I shërben ngastres është i detyruar të lejojë përdorimin e pronës për kontrollin, kalimin dhe kryerjen e punimeve në sistemin e kullimit.



### III. INFORMIMI DHE VEPRIMI I STRUKTURAVE VENDORE

#### *Neni 11*

- a. Kryepërqendër në bashkëpunim me Njësitë Administrative në kompetencat e parashikuara të ligjit Nr. 139/2015 kryen kontrollin mbi territorin dhe njofton strukturën përgjegjëse siç është Njësia e Kullimit.
- b. Njësia e Kullimit në bashkëpunim me Policinë Bashkiake marrin masa dhe veprime administrative të parashikuara në këtë rregullore.
- c. Njësia e Kullimit është e detyruar të japë çdo informacion teknik në lidhje me kanalet kulluese Njësive Administrative.

### IV. NDALIMET DHE PENALITETET

#### *Neni 12*

Gjatë shfrytëzimit/përdorimit të rrjetit të kanalizimit, ndalohe:

- a. hedhja e mbeturinave urbane të çdo lloji, mbetje të ngurta apo e lëngta në hapësirat e sistemit të kullimit.
- b. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve nga bordura e kanalit kullues ( vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues) , brenda një largësie 4 metër.
- c. hedhja apo shkarkimet nga mbetjet industriale, apo përpunuese, të stallave, baxhove, apo nga aktivitete të tjera me impakt në mjedis, etj
- d. çdo lloj ndërhyrje në sistemin kullues, ndërhyrje në veprat e artit, vendosja e veprave të reja të artit, gjurmimi, devijimi i vijave të ujit, mbulimi i atyre ekzistuese natyrore apo të ndërtuara nga njeriu dhe çfarëdo modifikimi në objektet e kanalizimit pa leje nga Njësia Përgjegjëse për Kullimin dhe Bashkia.

#### *Neni 13*

Kryerja e shkeljeve dhe kundravajtjeve denohen si më poshtë:

- a. hedhja e mbeturinave urbane të çdo lloji, mbetjeve të ngurta.
- b. ndërtimi ose ngritja e çdo ndërtese apo strukture, mbjellja e pemëve nga bordura e kanalit kullues ( vija e takimit të sipërfaqes së tokës me skarpatën e kanalit kullues) , brenda një largësie 4 metër.



- c. hedhja apo shkarkimet nga mbetjet industriale, apo përpunuese, të stallave, baxhove, apo nga aktivitete të tjera me impakt në mjedis, etj..
- d. çdo lloj ndërhyrje në sistemin kullues, ndërhyrje në veprat e artit, vendosja e veprave të reja të artit, gërmimi, devijimi i vijave të ujit, mbulimi i atyre ekzistuese natyrore apo të ndërtuara nga njeriu dhe çfarëdo modifikimi në objektet e kanalizimit pa leje nga Njësia Përgjegjëse për Kullimin dhe Bashkia.
- e. Pengimi , bllokimi në mënyra të tjera i stafit të autorizuar për inspektimin e infrastrukturës, në përputhje me nenin 45, të ligjit nr 24/2017 dhe nenin 10 të kësaj rregulloreje.
- f. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionura në këtë rregullore nga ana e Njesisë Përgjegjëse të Kullimit.
- g. Njësia përgjegjëse e kullimit në rast se konstaton kundër-vajtjet e parashikuara në shkronjat "a" , "b" , "c" dhe "d" të këtij neni njofton Inspektoriatin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Kundër-vajtjet dënohen me 50 mijë lekë gjobë dhe kundër-vajtësi është i detyruar të përballojë shpenzimet për rikthimin e objektit në gjëndjen e mëparëshme ( neni 46 pika 2 e ligjit nr 24/2017 , " Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit" ).
- h. Kundër-vajtjet e parashikuar në shkronjat "e" dhe "f" dënohen me 25 mijë lekë gjobë nga Bashkia konform dispozitave ligjore.

## **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### ***Neni 14***

Strukturat ekzistuese që administrojnë funksionin e kullimit vazhdojnë veprimtarinë e tyre deri në momentin që përshtaten në përputhje me rregulloren nga Organi Kompetent.

### ***Neni 15***

Rregullorja mund të përmirësohet në përshtatje me aktet nënligjore që do të dalin në zbatim të ligjit 24/2017 “Për ujitjen dhe kullimin” duke synuar integrimin e saj më kudrin rregullator që do të hartohet për ujitjen dhe mbrojtjen nga përmbytjet.

## **MBIKËQYRJA**



***Neni 16***

Mbikëqyrjen e zbatimit dhe respektimit të dispozitave të kësaj rregulloreje, e kryejnë organet kompetente të Bashkisë.

***Neni 17***

Kjo rregullore hyn në fuqi .....

A handwritten signature in black ink, consisting of several loops and strokes, located in the bottom right corner of the page.